



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.409/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Ramush Bardiqi dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Koalicionit për Familjen, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

- I. Pranohet si e bazuar ankesa e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.409/2025, e datës 06.02.2025.
- II. Subjektit Politik, Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 2.000.00 € (dymijë) Euro.
- III. Detyrohet Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën - II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë 06.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër Anr.409/2025, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Koalicionit Familja, me të cilën pretendohet se më datë 06.02.2025 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur se mbështetësi i subjektit politik "Koalicionit për Familjen", z.Smajl Balaj në profilin e tij në Facebook ka postuar një fotografi të konstruktuar ku duket logoja dhe simboli i Lëvizjes Vetëvendosje dhe disa simboli i 3 gishtave të ngritura lartë me këtë përshkrim: "*Ju të tre gishtave mos më thirrni ma në VVhatsappDosje! E kam shly këtë app*". Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim mbështetësi i subjektit politik "Koalicionit për Familjen", z.Smajl Balaj, ka shkelur dispozitat e nenit 34 pika 1.11 e LZP-së duke përhapur gjuhë të urrejtjes dhe shpifjes që do të mund të nxiste sulm ndaj të tjerëve. Duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë nga PZAP-i, që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ankesës si provë i ka bashkangjitur fotografi nga postimi në Facebook.

Më datë 07.02.2025, PZAP-i, e njoftoi Koalicionin për Familjen, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 07.02.2025, deri në ora 19:00, por PZAP-i, nuk ka pranuar përgjigje nga Koalicioni për Familjen.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, përkatësisht, fotografit e postimit të rrjetit social Facebook të mbështetësit të Koalicionit për Familjen, z.Smajl Balaj, fotografi të konstruktuar ku duket logoja dhe simboli i Lëvizjes Vetëvendosje dhe simboli i 3 gishtave të ngritura lartë me këtë përshkrim "*Ju të tre gishtave mos më thirrni ma në VWhatsappDosje! E kam shly këtë app.*"

Paneli vlerëson se gjuha e tillë e përdorur nga mbështetësi i Koalicionit për Familjen, Smajl Balaj është gjuhë fyese, dhe ka për qëllim ofendimin kundër subjektit politik, në këtë rast LVV-sw, që cenon dinjitetin e tyre në kuadër të fushatës zgjedhore, dhe se ku veprim sipas Panelit konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore ka për qëllim të krijojë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijoj atmosferë tensioni dhe përçarjeje. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe mbështetësit janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i simboleve dhe shkrimeve të tilla mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenit 34 pika l.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*".

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjisllacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjisllacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se Koalicioni për Familjen, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nënparagrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.409/2025, datë 09.02.2025

Kryesues i Panelit,

Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME

A.A.nr.49/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik: Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.409/2025, të datës 09.02.2025, në seancën e mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa e subjektit politik, Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.409/2025, të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.409/2025, të datës 09.02.2025, është vendosur: I. Pranohet si e bazuar ankesa e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.409/2025, e datës 06.02.2025. II. Subjektit Politik, Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 2.000.00 € (dymijë) Euro. III. Detyrohet Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë, ashtu që shfuqizohet vendimi Anr.409/2025, të datës 09.02.2025, i PZAP-së, të anulohet gjoba e shqiptuar dhe të vlerësoj se vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat dhe liritë e koalicionit për familjen dhe parimet e të drejtës zgjedhore.



PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të hedhet e palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 06.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër Anr.409/2025, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Koalicionit Familja, me të cilën pretendohet se më datë 06.02.2025 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur se mbështetësi i subjektit politik “Koalicioni për Familjen”, z. Smajl Balaj në profilin e tij në Facebook ka postuar një fotografi të konstruktuar ku duket logoja dhe simboli i Lëvizjes Vetëvendosje dhe disa simboli i 3 gishtave të ngritura lartë me këtë përshkrim: “*Ju të tre gishtave mos më thirrni ma në Whatsapp Dosje! E kam shly këtë app*”. Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim, mbështetësi i subjektit politik “Koalicionit për Familjen”, z. Smajl Balaj, ka shkelur dispozitat e nenit 34 pika 1.11 të LZP-së duke përhapur gjuhë të urrejtjes dhe shpifjes që do të mund të nxiste sulm ndaj të tjerëve. Duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë nga PZAP-i, që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ankesës si provë i ka bashkangjitur fotografi nga postimi në Facebook.

Më datë 07.02.2025, PZAP-i, e njoftoi Koalicionin për Familjen, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 07.02.2025, deri në ora 19:00, por PZAP-i, nuk ka pranuar përgjigje nga Koalicioni për Familjen.

PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka nxjerr vendimin Anr.409/2025, të datës 06.02.2025, me të cilin e ka aprovuar ankesën e subjektit politik LVV, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës Anr.409/2025, të datës 06.02.2025, subjekti politik, Koalicioni për Familjen, ka paraqitur ankesë, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e ankesës dhe konstatoi se në këtë rast ankesa është e palejuar, për arsye se:

Me neni 118, paragrafi 4, të Ligji nr. 08/1-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: “*Vendimi i PZAP-së, mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-ja, mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfaqshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës*”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se ankesa nuk lejohet kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës



Anr.409/2025, e datës 06.02.2025, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së ankesës e kushtëzuar me vlerën e gjobës së shqiptuar e cila duhet të jetë mbi 5,000 €, për të qenë e lejuar ankesa, dhe situatës kur ankesa lejohet pavarësisht vlerës së gjobës sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes së atakuar.

Në këtë rast vlera e gjobës e shqiptuar nga Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia është në shumën prej 2,000 €, e cila nuk e kalon shumën prej 5,000 €, dhe po ashtu natyra e çështjes nuk përbën përjashtim për lejueshmërinë e ankesës (përjashtimet pavarësisht vlerës), prandaj në këtë rast për shkak të lartësisë së gjobës së shqiptuar, ankesa është e palejuar.


Nga arsyet e paraqitura më lart, e në bazë të nenit 118.4, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË  
AA.nr.49/2025, më datë 13.02.2025

Kryetari i kolegjit  
Ragip Namani



Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

  
Punëtori i autorizuar  
Ovlaščeni radnik



Sheji i shkresës  
Oznaka spisa:

AA-49/2025

PLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

*Prishta*

1. Pasi marrësi, i cili me tërësi nuk e dorëzoi në vendin e kësaj detyrimi të bëhet dorëzimi i sa pas kësaj se ligjshmit me shkrim që për shkak të detyrimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës, së tije dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërkohës, fqini, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavешtjenja da radi dostavljanja bude u odlicjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćinstva, Primilaca nastojniku zgrade suseda licno zaposlenom na istom radnom mestu primilacem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u ta në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në dorën e banesës ose të lokarit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odhosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primilaca ( pribrano na vratima stana odhosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më \_\_\_\_\_ 201 \_\_\_\_\_ në ora \_\_\_\_\_ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes \_\_\_\_\_  
Razlog odbijanja prijema \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:  
Naslov pisma koja se dostavlja:  
*Artenoidin 13.02.2025*

Numri i shkojave: \_\_\_\_\_  
broj priloga *2*

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur  
më (me fjalë)  
Povrđujueno prijem gorenavenog pisma  
( i slovima )

*Mirjana 14.02.2025*

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që  
e ka marrë aktin në vend të tij  
Potpis primilca ili licn koje je  
pismeno primilo u znanju)

*14.43*

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkallëkum pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpisie, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.